

VENDIM**NR. 1 DT. 25.02.2016****I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME
TË SHOQERISË "BANKA CREDINS " SH.A.**

Sot, me datë 25.02.2016, në orën 10:00, në selinë e shoqërisë me adresë në Rr. « Ismail Qemali », Nr. 4, Tiranë, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë BANKA CREDINS SH.A., shoqëri anonime shqiptare, regjistruar në mënyrë të rregullt në Regjistrin Tregtar, me Vendim Nr. 28969, të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Tiranë, datë 31.01.2003 (referuar më poshtë si "Shoqëria").

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme iu njoftua të gjithë aksionerëve, në mënyrë të rregullt në respekt të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Statutit të Shoqërisë, me datën 04.02.2016, me anë të postës elektronike dhe nëpërmjet postës së Bankës dhe po atë datë u publikua edhe në faqen e bankës në internet www.bankacredins.com. Njoftimi u shoqërua në mënyrë të rregullt nga dokumentacioni përkatës i mbledhjes.

Ishin të përfaqësuar në Mbledhje **84.84** % e Kapitalit të Shoqërisë, e vërtetuar nga Lista e Pjesëmarrjes, e cila u nënshkrua nga të gjithë të pranishmit. Si konkluzion, Kuorumi i nenit 144 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me më shumë se 50% të kapitalit, është përmbushur. Mbledhja merr vendime me $\frac{3}{4}$ e aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

Mbledhja e Asamblesë u drejtua nga z. Maltin Korkuti. Sekretar i Mbledhjes u caktua znj. Dora Vako.
Rendi i ditës:

1. Propozim për rritjen e kapitalit të Bankes Credins në masën 10 milion Euro nëpërmjet emitimit të aksioneve të reja.

Asambleja e Përgjithshme pasi konfirmoi kompetencën e saj për të vendosur duke u bazuar në Ligjin Nr 9662, datë 18.12.2006 " Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe në Statutin e shoqërisë, në formën e vendimit:

VENDOSI:


1. Të zmadhohet kapitali i "BANKES CREDINS" SH.A. në vlerën 10,000,000 euro (dhjetë milion euro) nëpërmjet emitimit të aksioneve të reja. Në total numri i aksioneve që do të emetohen është 6.854.010 aksione me vlerë kontabël neto 201.2 leke /aksion ose 1.459 eur /aksion, konvertuar me kursin e ditës së Vendimit. Afati për të ushtruar të drejtën e parablerjes nga aksionerët e Bankes do të jete jo më vonë se 20 dite pas publikimit të njoftimit për zmadhimin e kapitalit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, e drejtë kjo që do të materializohet me nënshkrimin e aksioneve të reja, në të kundërt aksionerët humbasin të drejtën e nënshkrimit. Në rast se aksionerët ekzistues heqin dorë nga e drejta e perparemise, ose e humbasin atë me kalimin e afatit 20 ditor, aksionet e panënshkruara mund t'i ofrohen personave të tretë Afati për shlyerjen e aksioneve të reja të nënshkruara, caktohet të jete brenda datës 25.08.2016.
2. T'i delegojë Drejtorisë të gjitha kompetencat e nevojshme për të realizuar të gjitha procedurat në lidhje me kompletimin e transaksioneve të mësipërme, për të fiksuar modalitetet, për të gjetur investitore të mundshëm, për të nënshkruar kontratat e nënshkrimit, për të njoftuar Bankën e Shqipërisë lidhur me zmadhimin e kapitalit, si dhe për të bërë regjistrimet përkatëse pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve.



AKSIONARËT E SHOQËRISË

Aleksandër PILO

përfaqësuar nga Andon Daka



B.F.S.E Holding BV

përfaqësuar nga Sokol Nako




Renis TËRSHANA



Unioni Shqiptar Kursim Kredie

përfaqësuar nga

Egi SANTO



Emi SANTO



Monika MILO



Maltin KORKUTI



Ilirjan BUSHATI

Fuad HAXHIYMERI

Arjana SANTO

përfaqësuar nga Egi Santo



Kostaq MILO

SIFEM AG

përfaqësuar nga Sokol Nako



Neritan DOJAKA

Fadil ALLAJBEU

Jorgjia BALLI

Leonat KOCO

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'KOCO' with a large, sweeping flourish above it.

Veneranda BUSHATI

Gjergji BUSHATI

Viollca BUSHATI

Mirela NDINI

EDRO sh.p.k

A handwritten signature in blue ink, consisting of two distinct, stylized figures or shapes.

Edmond REXHO

Elisabeta HYSI


Pandeli GARO

Aida BUSHATI

Albens BUSHATI

Ervin BUSHATI

Andon DAKA

A handwritten signature in blue ink, featuring a series of horizontal, wavy lines with a large, looping flourish at the bottom.